




REPUBLIKA E KOSOVËS AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Loco Drejtoria Faqe	0PK
Numri i dokumentit Në prapitje	01/2312/13
Numri i dokumentit Në prapitje	01.08.13



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe (11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së punës të Agjencisë kundër korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër korrupsionit me datë **01.08.2013**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-1876/13 për z.Mejdi Bektashi – Anëtar i Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës, për shkak se është parandaluar situata e mundshme e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-1876-13, për Zyrtarin e lartë, z. Mejdi Bektashi – Anëtar i Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës, dhe njëkohësisht Prodekan për çështje të infrastrukturës dhe financave në Fakultetin Juridik në Universitetin “Hasan Prishtina” të Prishtinës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-1876/13, të hetuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari i lartë, z. Bektashi së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër korrupsionit (Z.D.DPK-01-1972/13), pas të cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Bektashi ka deklaruar se së shpejti do të filloj procedurën e tërheqjes nga funksioni i Prodekanit të Fakultetit Juridik, në mënyrë që të mbajë vetëm postin e Anëtarit të Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës.

Ndërkohë, zyrtari i lartë, ztr.Bektashi në Agjencinë kundër korrupsionit ka sjellur shkresë zyrtare, e cila përmbanë Dorëheqjen e tij nga posti i Prodekanit për çështje të infrastrukturës dhe financave në Fakultetin Juridik, të cilën i ka ofruar këtij fakulteti (DPK.03/2261/13).

Andaj , duke u bazuar në faktet dhe gjendjen reale, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër korrupsionit

/ Hasan Preteni /

